



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA




PROJEKTI FITUES ME TITULL:

**“STUDIM DHE ANALIZË MBI KOHERENCËN DHE STANDARDET
E PRITSHME TË SPECIALISTËVE GJUHËSORË
NË FUSHËN E TURIZMIT NË KONTEKSTIN SHQIPTAR”**

**FINANCUAR NGA UNIVERSITETI I TIRANËS
NË KUADËR TË PROGRAMIT “UT-KËRKIM, EKSELENCË DHE INOVACION”**

2023



EKIPI I PROJEKTIT:

Dr. Drita RIRA (drejtuese e projektit)

Prof. Dr. Esmeralda Kromidha

Prof. Dr. Saverina Pasho

Prof. Asoc. Dr. Ogerta Koruti

Prof. Asoc. Dr. Alnida Koroshi

Znj. Vasilika Mulla

PERIUDHA E ZBATIMIT TË PROJEKTIT:

Maj 2023 – Mars 2024



Universiteti i Tiranës

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja



PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Grupi i punës propozoi këtë projekt si një studim kërkimor për të nxitur shkëmbimin e praktikave më të mira, për të sjellë propozime me veprime konkrete në fushën e komunikimit dhe të trashëgimisë kulturore të vendit tonë, specifikisht me elementët që lidhen me diversitetin kulturor dhe gjuhësor në fushën e turizmit dhe potencialin evropianizues.



QËLLIMI

Projekti ka si qëllim të realizojë një studim shkencor që shënjestrohen ofertat e ndryshme që gjenden në treg si edhe të hetohen nga afër tendencat e tregut të cilat mbështesin nevojën e hapjes së formimeve të reja, duke ndikuar në përmirësimin e kurrikulave mësimore në institucionet e arsimit të lartë, veçanërisht në:

1. Teknikat komunikative në njohjen dhe rivlerësimin e trashëgimisë kulturore;
2. Përgatitja në kompetencë gjuhësore e specialistëve të fushës;
3. Kultura dhe komunikimi si një mjet evokues dhe guidë për destinacionet turistike;
4. Roli dhe kontributi i shumëgjuhësisë në sektorin e turizmit;

OBJEKTIVAT

- Promovim dhe ndërgjegjësim të burimeve turistike materiale e jomateriale shqiptare për studentët e UT-së, përmes aktiviteteve të Shkollës Verore të Turizmit dhe Kulturës, për njohje më të mirë të integritit të kurrikulës me kërkesat e tregut të punës.
- Përthithja e praktikave më të mira nga ekspertët e huaj dhe vendas, si modele të shëndetshme për studentët në zgjedhjet e tyre në tregun e punës, duke sjellë më afër komunikimin turistik në Shqipëri me kontekstin Evropian.
- Diskutim përmes një tavoline të rrumbullakët, me pjesëmarrjen e specialistëve akademikë, pedagogëve të FGJH-së si edhe operatorët turistikë, për të marrë informacion mbi nevojat e ofruesve të punësimit për profilin e turizmit në përputhje me shërbimet turistike që ofrohen.
- Studimi i tregut i konceptuar për të sjellë një analizë komplekse të impakteve sociale, të reformave në arsimin e lartë dhe nevojave për ta përshtatur ofertën që sjell arsimit të lartë me kërkesat e tregut të punës në Shqipëri.